

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Mars, 2017


Tiranë, më 20 Prill 2017: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Mars 2017 është 584.780. Krahasuar me Mars 2016, ky tregues rezulton me rritje 5,3 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 243.462. Krahasuar me Mars 2016, ky numër është rritur me 11,2 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në tremujorin e parë 2017 është rritur 7,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi gjatë muajit Mars 2017 janë 633.894 duke shënuar një rritje me 10,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2017 është 377.793. Krahasuar me muajin Mars 2016 ky numër është rritur 5,8 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në tremujorin e parë 2017 është rritur 1,7 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Hyrje-daljet e shtetasve në Shqipëri , Mars 2017



Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj, Mars 2017

Periudha	Mars-16	Mars-17	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Mars 16	Janar-Mars 17	Ndryshimi vjetor progresive (%)
Hyrje Gjithsej	555.151	584.780	5,3	1.469.197	1.517.427	3,3
Shqiptarë	336.293	341.318	1,5	907.249	915.487	0,9
Të Huaj	218.858	243.462	11,2	561.948	601.940	7,1
Dalje Gjithsej	571.959	633.894	10,8	1.625.421	1.673.616	2,9
Shqiptarë	357.179	377.793	5,8	1.028.255	1.046.113	1,7
Të Huaj	214.780	256.101	19,2	597.166	627.503	5,1

Numri i vizitorëve të huaj, të hyrë në Shqipëri për qëllime pushimi dhe vizita ditore në muajin Mars 2017, rezulton 66.589, ndërsa në Mars 2016 ky numër ishte 25.273.

Në Shqipëri, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë për qëllime personale në Mars 2017 është 237.995 dhe përbëjnë 97,8 % të numrit gjithsej të hyrjeve të shtetasve të huaj. Krahasuar me Mars 2016, numri i shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur 11,2 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri për qëllime biznesi përbën 2,2 % të hyrjeve të shtetasve të huaj, duke shënuar një rritje prej 12,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit, Mars 2017

Periudha	Mars-16	Mars-17	Janar-Mars 16	Janar-Mars 17
Hyrje Shtetas të Huaj	218.858	243.462	561.948	601.940
I. Personale	214.009	237.995	550.674	589.827
1. Pushime	23.409	66.589	53.394	114.858
2. Vizitë në miq e të afërm	970	967	3.172	2.202
3. Vizitë ditore	1.864	0	5.361	17.201
4. Trajtim shëndetësor	49	84	148	180
5. Qëllime fetare	78	61	254	132
6. Vizitorë të tjerë	176.548	160.153	456.363	429.850
7. Udhëtarë tranzit	11.091	10.141	31.982	25.404
II. Biznes dhe profesionale	4.849	5.467	11.274	12.113


Hyrjet e shtetasve të huaj, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 80,7 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore dhe detare zënë respektivisht 15,0 % dhe 4,3 %.

Tab.3 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit, Mars 2017

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Mars-16	75.750	28.732	450.669	71.404	27.225	473.330
Mars-17	87.908	25.118	471.754	87.735	27.632	518.527
Ndryshimi vjetor (%)	16,1	-12,6	4,7	22,9	1,5	9,5
Janar - Mars 2016	210.040	75.076	1.184.081	213.207	103.964	1.308.250
Janar - Mars 2017	247.844	69.040	1.200.543	260.097	106.023	1.307.496
Ndryshimi vjetor progresivë (%)	18,0	-8,0	1,4	22,0	2,0	-0,1

Numri më i madh i hyrjeve të shtetasve të huaj në vendin tonë, në muajin Mars rezulton nga Kosova me 33,4 %, pasuar nga hyrjet e shtetasve të huaj nga Maqedonia me 16,5 %, Greqia me 13,7 %, Mali i Zi me 13,1 %, etj.

Fig. 2 Shtetet me hyrjet më të mëdha në Shqipëri



Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>